

Data 11.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kontenierësh”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kosha mbeturinash 39224340-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 313 650 (tre milion e treqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa t.v.sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokastr** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2023, 2024, 2025**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo me te vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "b", të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "b", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit** të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit me shpenzimet e veta.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës deklaron se malli i ofruar përmbush të gjitha specifikimet teknike dhe është në përputhje me standartet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Për të provuar përmbushjen e kërkesave teknike, OE duhet të ngarkojë në SPE dokumentacionin përkatës që vërteton përmbushjen e standarteve të mëposhtme:

- SSH EN 840-2 ose standart ekuivalent dhe të vlefshme
- SSH EN 840-5 ose standart ekuivalent dhe të vlefshme
- SSH EN 840-6 ose standart ekuivalent dhe të vlefshme

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Kërkesa për përmbushjen e standardeve teknike **SSH EN 840-2, SSH EN 840-5 dhe SSH EN 840-6, ose standardeve ekuivalente dhe të vlefshme**, është përcaktuar me qëllim garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë, sigurisë dhe përshtatshmërisë teknike të koshave metalikë të ofruar. Këto standarde lidhen me kërkesat teknike, performancën, metodat e provave, si dhe kërkesat e sigurisë dhe ergonomisë për kontejnerët e mbetjeve.*

*Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë dokumentacionin përkatës provues në SPE synon të mundësojë **verifikimin objektiv të përputhshmërisë së mallit të ofruar me specifikimet teknike**, duke lehtësuar procesin e vlerësimit nga KVO-ja. Pranimi i standardeve ekuivalente dhe të vlefshme siguron që kërkesa të mos kufizojë konkurrencën dhe të lejojë produkte që ofrojnë nivel të njëjtë ose të barasvlershëm përmbushjeje.*

SPECIFIKIMI TEKNIK

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Furnizimi me kosha metalikë me kapacitet **1100 litra** dhe kosha metalikë me kapacitet **10 litra**, në përputhje me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor.

1. Kosha metalik (1100 L)

Koshat metalikë për mbetjet me kapacitet **1100 litra** duhet të plotësojnë këto kërkesa teknike:

- Të jenë të prodhuar në përputhje me standardet **SSH EN 840-2, SSH EN 840-5 dhe SSH EN 840-6** ose standarde ekuivalente dhe të vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa që koshat të jenë në përputhje me standardet **SSH EN 840-2, SSH EN 840-5 dhe SSH EN 840-6** ose standarde ekuivalente është vendosur për të garantuar cilësinë, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe ndërveprueshmërinë me automjetet teknologjike të grumbullimit të mbetjeve që disponon Autoriteti Kontraktor. Këto standarde përcaktojnë karakteristikat teknike, metodat e provës dhe kërkesat funksionale për kontejnerët e mbetjeve me kapacitet 1100 litra.

- Të jenë të kompletuar me kapak, katër (4) rrota, sistem frenimi me pedal në dy (2) rrota, dy (2) doreza tërheqëse dhe mekanizëm funksional për hapjen e kapakut.
- Kapaciteti nominal të jetë **1100 litra**.

Argumentimi: Kapaciteti prej 1100 litrash është zgjedhur pasi përfaqëson kapacitetin standard të përdorur nga Autoriteti Kontraktor në sistemin e menaxhimit të mbetjeve urbane. Ky kapacitet siguron grumbullimin efikas të mbetjeve, redukton frekuencën e zbrazjes dhe është plotësisht i përshtatshëm me automjetet ekzistuese të transportit.

- Trupi i koshit të jetë prej lllamarine çeliku të galvanizuar me zhytje në banjë zinku të nxehtë, me mbrojtje ndaj korrozionit dhe sipërfaqe të lëmuar.

Argumentimi: Materiali i galvanizuar siguron rezistencë të lartë ndaj korrozionit, lagështisë, kushteve atmosferike dhe agjentëve kimikë që krijohen nga mbetjet urbane. Galvanizimi me zhytje në banjë zinku rrit ndjeshëm jetëgjatësinë e produktit dhe ul kostot e mirëmbajtjes gjatë përdorimit.

- Trashësia minimale e lllamarinës të jetë:
 - Trupi: $\geq 1.25 \text{ mm}$;
 - Fundi: $\geq 1.50 \text{ mm}$.

Argumentimi: Trashësitë minimale janë përcaktuar për të garantuar rezistencën mekanike të kontejnerit gjatë ngarkimit, zbrazjes dhe transportit, si dhe për të shmangur deformimet apo dëmtimet e parakohshme që shkaktohen nga pesha e mbetjeve dhe goditjet gjatë përdorimit të përditshëm.

- **Kapaku të jetë metalik i galvanizuar.**

Argumentimi: Kapaku metalik garanton rezistencë më të madhe ndaj goditjeve, rrezeve UV dhe kushteve atmosferike krahasuar me materiale të tjera. Galvanizimi mbron kapakun nga korrozioni dhe rrit jetëgjatësinë e tij.

- Forma e koshit të jetë **trung piramide e përmbysur**, për të mundësuar zbrazje të lehtë të mbetjeve.

Argumentimi: Kjo formë lehtëson zbrazjen e plotë të mbetjeve, shmang bllokimet gjatë shkarkimit dhe siguron funksionimin korrekt të mekanizmit të ngritjes së automjeteve të grumbullimit.

- Koshi të jetë i pajisur me dy (2) doreza anësore për manovrim dhe transport deri te automjeti i grumbullimit të mbetjeve.

Argumentimi: Prania e dy dorezave mundëson manovrim të sigurt dhe ergonomik nga përdoruesit gjatë lëvizjes së kontejnerit, duke rritur sigurinë në punë dhe lehtësuar transportimin.

- Të jetë i përshtatshëm për ngritje dhe zbrazje nga automjetet teknologjike të transportit të mbetjeve, sipas standardeve të mësipërme.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar përputhshmërinë me mekanizmat ngritës të automjeteve ekzistuese të Autoritetit Kontraktor, duke shmangur nevojën për pajisje shtesë ose modifikime.

- Përmasat orientuese të jenë:
 - Gjatësia: **1370 mm**;
 - Gjerësia: **990 mm**;
 - Lartësia: **1350mm**;
 - me tolerancë $\pm 50 \text{ mm}$.

Argumentimi: Përmasat janë orientuese dhe janë përcaktuar në funksion të kapacitetit 1100 litra dhe përputhshmërisë me automjetet e grumbullimit. Lejimi i tolerancës ± 50 mm siguron konkurrencë më të gjerë ndërmjet operatorëve ekonomikë pa cenuar funksionalitetin.

- Krahët ngritës duhet të jenë të projektuar dhe prodhuar në përputhje me standardet **SSH EN 840-2, SSH EN 840-5 dhe SSH EN 840-6** ose ekuivalente dhe të vlefshme, duke siguruar përputhshmëri me mekanizmat standardë të ngritjes së automjeteve të grumbullimit të mbetjeve. Trashësia minimale e materialit të krahëve ngritës duhet të jetë **2.50 mm**.

Argumentimi: Krahët ngritës duhet të jenë të përputhshëm me standardet përkatëse për të garantuar ngritjen dhe zbrazen e sigurt nga automjetet e grumbullimit, duke shmangur aksidentet dhe dëmtimet gjatë operimit. Trashësia minimale prej 2.50 mm është kërkuar për të siguruar rezistencë ndaj ngarkesave dinamike dhe cikleve të përsëritura të ngritjes gjatë gjithë jetës së shërbimit të kontejnerit.

Rrotat

Rrotat e koshit duhet të plotësojnë këto karakteristika:

- Të jenë prej gome të plotë, rezistente ndaj konsumimit dhe goditjeve.
- Struktura mbajtëse të jetë prej çeliku të galvanizuar, e pajisur me kushineta.
- Disku i rrotës të jetë prej polipropileni.
- Diametri i rrotës të jetë **200 mm**.
- Gjerësia (trashësia) e rrotës të jetë **50 mm**.
- Pllaka e fiksimit të ketë përmasa **115 × 141 mm**.
- Hapësira ndërmjet vrimave të fiksimit të jetë **105 × 80 mm**.
 - me tolerancë ± 10 mm.
- Çdo kosh të jetë i pajisur me **katër (4) rrota**, prej të cilave **dy (2) me frenim me pedal dhe dy (2) pa frenim**.

Argumentimi: Rrotat kërkohen të jenë prej gome të plotë me qëllim garantimin e rezistencës së lartë ndaj konsumimit, deformimeve dhe goditjeve që krijohen gjatë përdorimit të përditshëm në ambiente urbane. Goma e plotë nuk shpohet dhe nuk kërkon mirëmbajtje, duke siguruar funksionim të vazhdueshëm dhe jetëgjatësi më të madhe të kontejnerit.

Struktura mbajtëse e rrotave kërkohet të jetë prej çeliku të galvanizuar për të siguruar rezistencë të lartë mekanike dhe mbrojtje ndaj korrozionit të shkaktuar nga lagështia, reshjet atmosferike dhe lëndët agresive që gjenden në mbetjet urbane. Pajisja me kushineta garanton rrotullim të lehtë, ul fërkimin gjatë lëvizjes dhe rrit jetëgjatësinë e mekanizmit të rrotës.

Disqet prej polipropileni janë kërkuar pasi ky material karakterizohet nga rezistencë e lartë ndaj goditjeve, lagështisë dhe agjentëve kimikë, si dhe ka peshë të ulët. Kjo ndikon në lehtësimin e manovrimit të kontejnerit dhe në rritjen e jetëgjatësisë së rrotës.

Diametri 200 mm është përcaktuar pasi mundëson lëvizje të lehtë të kontejnerit edhe në sipërfaqe jo plotësisht të rrafshëta, si trotuare, rrugë me kalldrëm apo asfalt të amortizuar. Ky dimension është gjithashtu standard për kontejnerët metalikë me kapacitet 1100 litra dhe garanton manovrim të sigurt edhe në kushte ngarkese maksimale.


Trashësia prej 50 mm siguron shpërndarje më të mirë të ngarkesës mbi sipërfaqen e kontaktit, rrit stabilitetin gjatë lëvizjes dhe ul konsumimin e gomës. Ky parametër ndikon gjithashtu në funksionimin normal të kontejnerit gjatë përdorimit intensiv.

Dimensionet e pllakës së fiksimit janë përcaktuar për të garantuar montim të sigurt të rrotës në trupin e kontejnerit, shpërndarje uniforme të ngarkesës dhe rezistencë ndaj forcave dinamike që krijohen gjatë lëvizjes dhe zbrazjes së kontejnerit.

Këto përmasa janë vendosur për të siguruar përputhshmëri me sistemet standarde të montimit të përdorura nga prodhuesit e kontejnerëve sipas standardeve EN 840 ose ekuivalente. Vendosja e tolerancës ± 10 mm shmang kufizimin e konkurrencës dhe lejon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që ofrojnë produkte me ndryshime minimale dimensionale, pa cenuar funksionalitetin dhe sigurinë.


Kërkesa që kontejneri të pajiset me katër rrota, ku dy prej tyre të jenë me sistem frenimi me pedal dhe dy pa frenim, është vendosur për të garantuar njëkohësisht lëvizshmëri dhe siguri në përdorim. Frenat parandalojnë lëvizjen e pakontrolluar të kontejnerit gjatë vendosjes në terrene me pjerrësi ose gjatë ngarkimit me mbetje, duke rritur sigurinë e operatorëve dhe të qytetarëve. Ndërsa dy rrotat pa frenim sigurojnë manovrim të lehtë dhe drejtim efikas gjatë transportimit.





RROTA

PLLAKE E FIKSIMIT




2. Kosha metalik (10 L)

Kosh metalik urban për mbeturina, për ambiente të jashtme:

- trup cilindrik metalik me diametër rreth **26 cm** dhe lartësi **94 cm**;
 - me tolerancë ± 5 cm.
- strukturë e fiksuar në tokë (jo me rrota, jo i lëvizshëm);
- material çelik i galvanizuar ose inox me përfundim rezistent ndaj shiut, diellit dhe korrozionit;
- pjesë e brendshme me **kosh plastik të lëvizshëm** për zbrazje dhe pastrim të lehtë;
- dizajn modern për trotuare, parqe, sheshe dhe hapësira publike;
- ngjyrë gri metalike ose e zezë me veshje elektrostатike;
- bazament i fortë për ankorim në sipërfaqe betoni.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kosha metalik 10 L është i përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme dhe hapësira publike, si trotuare, parqe dhe sheshe. Ai përbëhet nga trup cilindrik metalik me diametër rreth **26 cm** dhe lartësi **94 cm**, me tolerancë ± 5 cm, përmasa të cilat sigurojnë kapacitet dhe formë të përshtatshme për përdorim urban. Struktura është e fiksuar në tokë dhe jo me rrota, duke garantuar qëndrueshmëri dhe siguri gjatë përdorimit. Materiali prej **çeliku të galvanizuar ose inoksi**, me përfundim rezistent ndaj shiut, diellit dhe korrozionit, siguron jetëgjatësi dhe mirëmbajtje të ulët. Koshja e brendshme plastike e lëvizshme mundëson zbrazje dhe pastrim të lehtë. Ngjyra gri metalike ose e zezë me veshje elektrostатike dhe bazamenti i fortë për ankorim në beton plotësojnë kërkesat për një kosh funksional, rezistent dhe me pamje moderne



Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSI E PROKURIMIT

Rigelsa Alikaj

Lorjana Shehu

Esmeralda Bezhani